



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 26 qershor 2019, në mbledhjen e tretë (3) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Osman Kurtolli, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë dhe z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; znj. Antigona Çitaku Dibrani, shefe e Sektorit të Operativës në Stacionin Policor Podujevë; z. Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Bekim Karaxhia – OSBE dhe përfaqësuesi i Zyrës së UNMIK-ut.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, përshëndetje të gjithëve, pasi që Kryetari është zyrtarisht jashtë vendit ne do të fillojmë me mbledhjen e KKSB-së. Në takim kemi znj. Antigona Çitaku Dibrani, shefe e Sektorit të Operativës në Stacionin Policor Podujevë, që zëvendëson Komandantin e Stacionit të Policisë, i cili sot për shkak të angazhimeve nuk mund të marr pjesë në takim. Materialet konsideroj se i keni marrë të gjithë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës
U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 30 prill 2019

z. Qefser Behrami, kërkoi të korrigjohet lëshimi teknik te mbiemri i tij në faqen nr.5 të procesverbalit.

z. Osman Kurtolli, theksoi, në pjesën hyrëse të procesverbalit, ku janë të evidentuar emrat e pjesëmarrësve në mbledhje nuk figuron emri i tij. Kërkoj që kjo të korrigjohet.

Me vërejtjet për korrigjimin e lëshimeve teknike njëzëri u miratua procesverbali.

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- **Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-it për sigurinë në komunë**

- **Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë**

z. Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka znj. Antigona Çitaku Dibrani, pastaj vazhdojmë me informatat që do të japin përfaqësuesi i KFOR-it dhe ai i FSK-së.

znj. Antigona Çitaku Dibrani, theksoi, sa i përket gjendjes së sigurisë në Komunë, vlerësohet e qetë pa ndonjë tendencë të përkeqësimit apo ngritjes së shkallës së kriminalitetit. Gjatë muajit maj të raportuara kanë qenë gjithsejtë 87 raste, ndërsa nga data 1-25 qershor kemi 55 raste të raportuara, do të thotë kemi ulje të shkallës së raportimit të rasteve. Sa i përket planeve operative, Stacioni Policor ka në implementim një mori planesh operative, siç janë; për sigurinë në komunikacion, për tollovitë e ndryshme nëpër sportele të bankave dhe institucione të ndryshme, për parandalimin e të shtënave në ahengje dhe dasma, për arrestimin e personave të kërkuar nga gjykata, ku me zbatimin e këtij plani jemi duke u treguar më të suksesshmit në rajon, etj. Nga ky vikend do të angazhohemi për implementim të Planit operativ në parandalimin e të shtënave në ahengje dhe dasma dhe do të vazhdojë deri në përfundim të sezonit veror. Shpresojmë se do të kemi rezultate në parandalimin e të shtënave edhe pse kohët e fundit është shënuar se ka rënie. Nga data 06 maj kemi filluar me implementimin e projektit për vetëdijesimin e qytetarëve nga rreziqet e zjarreve të ndryshme, ku janë mbajtur takime në fshatrat Kërmimeh dhe Orllan, pra janë mbajtur ligjërata për vetëdijesimin e banorëve në luftimin e kësaj dukurie. Shpresojmë se nuk do të kemi probleme në këtë aspekt, megjithatë ne jemi të gatshëm edhe me akterët tjerë kompetentë t'i përgjigjemi këtyre rasteve. Sa i përket rasteve të dhunës në familje, në rajonin e Komunës së Podujevës ka raste të ngritjes së lehtë të dhunës në familje. Ne i kemi bërë analizë të gjitha rasteve të raportuara. Në muajin maj 2018 kanë qenë 6 raste, ndërsa në qershor 2018 kanë qenë 4 raste. Në muajin maj 2019 kanë qenë 6 raste, ndërsa në qershor 9 raste të raportuara. Rastet janë proceduar. Sa i përket Strategjisë së trajtimit të rasteve të dhunës në familje Policia aplikon pakon e viktimave, ku secila viktimë shërbehet me pako. Nga analizat e bëra të këtyre rasteve, rezulton se realisht nuk kemi të bëjmë me shtim të numrit të rasteve të dhunës në familje, të gjitha 9 rastet janë që datojnë me vite, por që viktimat nuk i kanë raportuar. Faktorët të cilët kanë ndikuar dhe ndikojnë në këto raste janë të ndryshëm, e që mund të përmenden; vetëdijesimi për raportim, kushtet ekonomike, niveli i ulët i shkollimit, problemet psikologjike, martesat apo lidhjet e hershme, rrjetet sociale që dmth kanë një efekt shumë negativ sa i përket rasteve të dhunës në familje, tradhtitë e ndryshme, varshmëria nga përdorimi i substancave narkotike etj. Rreshterja foli edhe për zyrtarët përgjegjës të trajnuar për trajtimin e këtyre rasteve. Me qëllim të senzibilizimit dhe uljes së numrit të këtyre rasteve ne në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë Rajonale mbajmë ligjërata vetëdijësuese përfshirë edhe rajonet rurale, duke mbajtur takime me persona të gjinisë femërore, me nivel të ulët të shkollimit, me qëllim të vetëdijesimit të tyre dhe që të kenë një adresë referuese. Sa i përket sezonit veror nevojitet angazhim shtesë duke pasur parasysh planet që do të na paraqiten, duke mos përjashtuar edhe situatat e jashtëzakonshme. Siç jeni në dijeni Stacioni Policor i Podujevës ka mungesë të numrit të zyrtarëve policor por shpresojmë se me daljen e

gjeneratës së re në muajin shtator të plotësohet numri me personel, megjithatë përveç numrit kemi vështirësi edhe sa i përket moshës së zyrtarëve policor që kemi, ku një numër i konsideruar janë mbi moshën 50 vjeçare, por ka edhe të tjerë me sëmundje kronike, pra këto janë disa pengesa që na paraqiten, mirëpo edhe përkundër këtyre, e them me përgjegjësi të plotë po ia dalim, e mbajmë situatën nën kontroll. Rastet e paraqitura janë në suaza të normales, janë vepra penale apo incidente ordinere të cilat nuk përkeqësojnë sigurinë e përgjithshme. Në këto dy periudha kanë dominuar rastet e vjedhjeve të lehta, vjedhje të pajisjeve bujqësore, të cilat fermerët nuk i bartin në shtëpi, por i lënë në fusha, ara etj., pra këto raste e kanë ngritur numrin e vjedhjeve, mirëpo qëndrojmë mirë për faktin se gjatë këtyre dy muajve nuk kemi asnjë rast të vrasjes, grabitjeve që kemi pasur vitin e kaluar, pra në këtë aspekt e përsëris, sigurinë e përgjithshme e kemi të qetë dhe stabile.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, nga pikëpamja e KFOR-it gjendja e sigurisë vlerësohet e qetë dhe stabile, nuk kemi diçka për të raportuar.

z. Naim Bajraktari, theksoi, sipas vlerësimeve tona situata e përgjithshme e sigurisë në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile. Edhe pse për nga territori realisht është Komuna më e madhe në Kosovë, me më se 130,000 banorë, Komuna e Podujevës hyn në radhën e Komunave më të qeta dhe më stabile në vend. Këtë gjendje të sigurisë ua atribuojmë organeve kompetente dhe njëherit mirënjohje ndaj vetëdijesimit të qytetarëve kundruall dukurive negative dhe bashkëpunimit të ndërsjellë me institucionet tjera përgjegjëse.

z. Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, e hap diskutimin, nëse keni pyetje lidhur me këtë çfarë u raportua, por edhe pyetje tjera që kanë të bëjnë me gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Podujevës.

z. Qefser Behrami, theksoi, në këtë aspekt a duhet të bëjmë vetëm pyetje dhe fjalë apo duhet kryer edhe punë. Unë kam potencuar se kemi rrezikshmëri të madhe të shkolla e fshatit Kërpimëh, për shkak të vozitësve të pandërgjegjshëm, në veçanti ngasësit e traktorëve dhe automjeteve tjera në atë segment të rrugës i lëshojnë në shpejtësinë O, ku është e pamundur të ndalen dhe aty lëvizin nxënësit, pra është problem shumë i madh, ndoshta mund të vijë edhe deri te më e keqja. Desha të potencoj edhe çështjen e qenve endacak, frikohem se për shkak të agresivitetit do të sulmojnë edhe banorët, aq më keq ndonjë fëmijë. Dua të flas edhe për një çështje të cilën e kam ngritur më herët, shkolla e vjetër e fshatit Kërpimëh është para që ka filluar me punë në territorin e Komunës së Podujevës. Është kërkesë e banorëve që të bëhet renovimi i objektit të shkollës së vjetër, e cila do të mund të përdorej për kabinete të ndryshme sepse shkolla aktuale nuk është funksionale me kabinete për shkak të hapësirës. Pastaj problem tjetër që vlen theksuar është se në objektin e kësaj shkolle në orët e vona hyjnë persona të pandërgjegjshëm dhe këtë e shoh si një rrezikshmëri të madhe. Kërkesa është që nëse ka mundësi të bëhet renovimi i objektit të vjetër të shkollës, kjo do të ishte më mirë se sa të rrënohet objekti. Çështje tjetër është se në shkollë nuk kemi ujë të pijes. Gjatë sezonit të verës banorët ujitin kopshtet, arat dhe ne s'kemi ujë. Punëtorët teknik furnizohen me ujë nga shtëpitë përreth për pastrimin e objektit. Për sigurimin e ujit shumë kohë më parë është bërë kërkesë edhe nga Bordi i shkollës.

z. Agim Blakçori, pyeti Drejtorin e Shkollës, pasi që ka problem me furnizim me ujë, si gjenden, kur është në pyetje edhe mirëmbajtja.

z. Qefser Behrami, janë disa kërkesa të parashtruara që i referohen furnizimit me ujë. Aty është një pus i hapur dhe ai bën grumbullimin e ujit vetëm kur ka reshje shiu. Kemi pasur në dispozicion ujin me rënie të lirë qysh në kohën e ish Jugosllavisë dhe rrjedhja e

tij shkon te pusi për grumbullim dhe për këtë ka qenë dashur të jetë në dijeni Drejtori i DA. E përsëris, uji ndalet në sezonin e verës.

z. Agim Blakçori, pusët janë, por nëse nuk mjaftojnë bëni kërkesë për hapjen e ndonjë pusi tjetër, për një burim shtesë.

z. Qefser Behrami, theksoi, disa herë kam parashtruar kërkesa edhe për rregullimin e një fushe sportive.

z. Nexhmi Rudari Nënkrjetar i Komunës, kërkesat e tilla për investime në projekte mund t'i bëni në drejtoritë përkatëse. KKSBB nuk ka mandatin e miratimit të kërkesave për realizim të projekteve, por sidoqoftë këtë e shohim si një çështje të ngritur.

z. Faik Muçiqi, falënderoj rreshteren për raportin e përgjithshëm për gjendjen e sigurisë. Unë fillimisht do t'i falënderoja për aksionin për lirim e hapësirave publike, kur dihet se edhe vet punimet në rrugën kryesore të qytetit kanë vënë në vështirësi qarkullimin e lirë të komunikacionit dhe për fat të keq këto do të na përcjellin gjatë verës dhe do të kemi vështirësi në komunikacion brenda qytetit, këta disa muaj, por do t'i koordinojmë aktivitetet. Një aksion i mirëpritur i policisë, emergjencave, inspektorëve dhe akterëve tjerë që gjatë muajit të kaluar dhe këtë muaj në tërë territorin e Komunës kanë dalë për të bërë evidentimin e gropave të cilat janë krijuar nga faktorë të ndryshëm. Disa prej tyre janë krijuar nga kompani të ndryshme nga nxjerrja e materialit, disa janë identifikuar si gropa personale, etj. Gropa të Miniera e fshatit Herticë që cilësohet si problem i Agjencionit për Miniera dhe Minerale, është shkaktuar nga hulumtimet dhe nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme, kjo është përgjegjësi institucionale dhe ne e kemi adresuar kërkesën për mbyllje. Një gropë të cilën e kemi cilësuar si më të rrezikshme e kemi proceduar në prokurim për mbyllje. Disa të tjera duhet të vazhdojmë për t'i mbyllur, që kanë mbetur maleve, arave, të cilat janë hapur si rezultat i nxjerrjes së materialit për rrugë, zhavorrit etj. Në Komunën tonë janë bukur shumë prej tyre, por jemi në proces të mbylljes. Rastet personale të gropimeve i kemi urdhëruar familjet që ti mbyllim. Eventualisht nëse ka të tjera që nuk janë evidentuar, të lajmërohen për t'i mbyllur.

z. Nuhi Selimi, theksoi, si objekt me rrezikshmëri kemi evidentuar një gur te liqeni i Batllavës në pjesën të plepat, i cili paraqet rrezik për qytetarët që vijnë te liqeni. Është mirë që guri të largohet tani, është më lehtë pasi që dukshëm ka rënë niveli i ujit.

z. Qefser Behrami, theksoi, përfaqësuesi i fshatit Dumnicë ka njoftuar për një gropë e cila është me rrezikshmëri.

znj. Antigona Çitaku Dibrani, të pranishmit parashtruan disa pyetje, unë do i referohem vetëm atyre që mund të jap përgjigje. Sa i përket shqetësimit nga qentë endacak kjo nuk është kompetencë e Policisë. Sipas legjislacionit në fuqi Policia nuk ka autorizime për eliminimin fizik të qenve, përveç rasteve kur rrezikohet drejtpërdrejtë jeta e qytetarëve. Ka ankesa të shumta nga qytetarët. Sa i përket rrezikut të komunikacionit afër shkollës në fshatin Kërpimëh, Policia me kapacitetet që posedon në zonë të përgjegjësisë prej 633 km² mundohet të jetë prezentë në çdo rajon. Kemi të evidentuara pikat e rrezikshme të cilat kanë prioritet të vendosjes së pikave kontrolluese të automjeteve. Në bazë të statistikave që Stacioni i Podujevës posedon nuk kemi asnjë rast të fatalitetit që ka ndodhur në atë lokacion dhe në raport me këtë përparësi u japim pikave ku ka pas raste të aksidenteve, në veçanti ku kanë qenë me fatalitet. Rreshterja përmendi disa lokacione të evidentuara me rrezikshmëri në komunikacion, në të cilat ka pas raste të aksidenteve me fatalitet. Nënvizoi, pavarësisht kësaj Policia nuk është se nuk qarkullon, fjala vjen për festimin e Ditës së Shkollës në Kërpimëh kemi qëndruar tërë ditën, pastaj kemi mbajtur ligjëratë në të njëjtën shkollë, që do të thotë se nuk qëndron se nuk jemi prezentë në atë pjesë, mirëpo është pamundur për të qenë prezentë në çdo kohë, në secilin lokacion. Secili vozitës është i obliguar t'i respektoj rregullat e komunikacionit dhe në

momentin që bie ndesh me to, ndëshkohet për kundërvajtjen e shkaktuar, ndërsa rastet trajtohen me prioritet ashtu siç është rregulluar me rregullativat e brendshme që kemi, rasteve më të ndjeshme u jepet prioritet. Duhet të jeni në dijeni se në terren janë dy njësi të Policisë që duhet ta mbulojnë tërë rajonin. Shpresojmë që do të shtojmë edhe numrin e personelit.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, po e përmbyllim këtë pikë të rendit të ditës me konstatimin që përkundër disa çështjeve që na shqetësojnë, mund të themi se gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës është e qetë, stabile dhe në menaxhim të plotë nga institucionet lokale dhe institucionet tjera që kanë përgjegjësinë për siguri. Kjo nuk do të thotë që ne duhet të jemi të kënaqur dhe të mos parashohim mundësitë e përkeqësimit të kësaj gjendjeje. Një prej çështjeve që u cek nga Rreshterja është koha e ahengjeve dhe dasmave që shpesh herë ka pas raste të plagesave por edhe me fatalitet edhe pse kjo dukuri është në rënie, nuk po manifestohet sikurse ka qenë para disa viteve, që fatmirësisht edhe tradita dhe mënyra e organizimit të dasmave ka ndërruar.

Qefser Behrami, në diskutimin paraprak nuk theksova se Policia e Kosovës nuk është aktive, por qëllimi dhe kërkesa ime është që në atë aks rrugor të vendosen pengesa.

znj. Antigona Çitaku Dibrani, kërkesa që ceku parafolësi nuk është në përgjegjësi të Policisë por e institucioneve të Komunës.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, adresa për parashtrimin e kërkesave për vendosjen e pengesave në rrugë është Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, por ne nuk mund të nisemi prej këtij konstatimi që të gjitha rrugët që i kemi të vendosim pengesa. Një prej dështimeve në infrastrukturë është rruga që lidhë fshatrat Letancë-Bajčinë që shkaku i pengesave të shpeshta qytetarët nuk e shfrytëzojnë por vazhdojnë ta shfrytëzojnë rrugën kryesore Kërpimëh – Podujevë. Po të mos ishin të gjitha ato pengesa, rruga kryesore do të shkarkohej. Në uljen e shkallës së rrezikshmërisë në masë ka ndikuar ndërtimi i trotuareve sidomos pran shkollave dhe nëse në ato pjesë të rrugëve ka nevojë për zgjatjen e trotuareve ne jemi të gatshëm, por duhet të ketë një vlerësim të shkallës së rrezikshmërisë në atë pjesë. Unë falënderoj tre raportuesit për gjendjen e sigurisë në Komunë të Podujevës, është mirë që trendi i veprave penale dhe veprave tjera kundërvajtëse është në rënie. Kalojmë në pikën e radhës.

3. Masat parandaluese kundër djegieve të pyjeve (Koordinimi i aktiviteteve në mes DBPZHR,DSHPMSH,SHZSH, Policisë, Agjencionit Pyjor, Agjencionin e Menaxhimit Emergjent si dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrje-shirjeve

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, foli për punët dhe aktivitet e nevojshme në funksion të parandalimit të djegies së pyjeve, Theksoi domosdoshmërinë e ngritjes së shkallës së bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të institucioneve relevante. Ndër të tjera potencoi edhe faktorin njeri, si një prej shkaqeve të shkaktimit të zjarreve, si dhe theksoi nevojën e hartimit të një plani veprimi për parandalimin e djegieve të pyjeve, së paku për periudhën korrik-gusht për shkak të temperaturave të larta. Fillimisht fjalën ia dha Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Vezir Januzi.

z. Vezir Januzi, theksoi, pyjet janë aset i një rëndësie të veçantë dhe pasuri kombëtare. Nga 633 km² sa ka Komuna e Podujevës, me pyje janë të mbuluar 26,962 ha prej të cilave 11,852 ha i takojnë pronës private dhe 15,110 ha janë prone shtetërore.

Gjithashtu foli edhe për kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore sa i përket mbrojtjes së pyjeve shtetërore dhe atyre në pronësi private si dhe për ndarjen e sipërfaqeve pyjore në Njësi menaxhuese, dhe për njësitë e ndara në Rajone Ekonomiko-Pyjore(REP).

Që nga data 13.07.2010 kompetencat në mbrojtjen e pyjeve kanë kaluar në Komunë, konkretisht në DBPZHR, ndërsa punët profesionalo-teknike i kryejnë zyrtarët nga Drejtoria Koordinuese Rajonale e APK-së në Prishtinë.

Gjatë sezonit veror APK-ja për çdo vit angazhon punëtorë sezonal të cilët intervenojnë në rastet kur paraqiten zjarre pyjore kurse kohën tjetër angazhohen në pastrime dhe rrallime parakomerciale. Gjatë periudhës 11.03.2018 - 23.04.2018 kemi pasur 11 raste të shfaqjes së zjarreve me intensitet të ulët, të mesëm dhe të lartë që kanë përfshi një sipërfaqe prej 26.10 ha, ndërsa këtë vit vetëm gjatë muajit mars kemi pasur 47 raste të zjarreve pyjore ku janë përfshi 414.45 ha. Çdo vit nga APK-ja hartohet Plani Menaxhues. Gjatë vitit kalendarik është e paraparë që çdo teren të kontrollohet d.m.th. të regjistrohet së paku një herë e sipas nevojës edhe më shumë. Deri më tani janë kryer regjistrime në dy terrene. Me kërkesa të Njesisë hetimore nga Stacioni policor i Podujevës kemi dalë në gjashtë (6) raste për vlerësime të dëmeve pyjore në prona private si pasojë e vjedhjes së masës drunore nga persona të huaj. Aktualisht është duke u zhvilluar procedura për shpalljen e tenderit për disa ngastra pyjore për shitjen e masës drunore në këmbë, masë drunore e cila është damkosur nga APK-ja dhe e lejuar për prerje me Plan Menaxhues për vitin 2019.

Sa u përket pyjeve private, pronarët e pyjeve private me ligj kanë të drejtë aplikimi për prerje pylli nga muaji janar-mars për çdo vit kalendarik. Kërkesat e tyre përcjellën në Drejtorinë Rajonale Koordinuese të APK-së në Prishtinë ku zyrtarët/ekspertët e fushës bëjnë shqyrtimin e tyre në teren e pastaj ato kthehen në DBPZHR e cila i përgatit lejet për prerje pylli. Këtë vit nga pronarët e pyjeve private janë parashtruar 322 Kërkesa për prerje pylli, deri më tani nga zyrtarët e APK-së janë shqyrtuar 44, ndërsa taksë për shërbime në pyje private është paguar për 35 prej tyre dmth. janë lëshuar 35 leje për prerje pylli.

Nga kontrollet e zhvilluara nga stafi i sektorit, Inspektorati pyjor dhe Policia kufitare deri më tani janë konfiskuar 128.28 metër³.

Deri më tani kemi zhvilluar një tender për shitje të masës drunore të konfiskuar si rezultat i transportimit ilegal, me ç'rast janë shitur 315.00 m³ në vlerë 16005.00 €

Meqë ndodhemi në prag të sezonit të korrije-shirjeve do formohet shtabi për përcjelljen e tyre që do sensibilizojnë opinionin lidhur me mbrojtjen e hamulloreve nga zjarret sepse ato ndikojnë negativisht në vetit biologjike të tokës.

z. Faik Muçiqi, informoi të pranishmit për punët dhe aktivitetet e Shërbimit të Zjarrfikësve lidhur me intervenimet dhe masat parandaluese kundër zjarreve. Theksoi, nga muaji janar deri në ditën e djeshme janë bërë 380 intervenime, prej tyre 354 janë zjarre, të tjerat kanë qenë në aksidente, evakuime etj. Nga lajmërimet ka qenë vetëm një informatë e rrejshme që nënkupton për ngritje të vetëdijesimit të qytetarëve. Muaji i prillit ka qenë periudha ku në masë ka pas raste të djegies së pyjeve ku shihet edhe nga raporti i zjarrfikësve, 245 kanë qenë intervenime kryesisht në pyje. Meqenëse muaji qershor ishte me reshje të shiut është ndalë intensiteti i djegieve. Sigurisht që kah fundi i qershorit dhe fillimi i korrikut pritet intensiteti i djegieve, që mund të shtohen gjatë korrije shirjeve. Shërbimi i zjarrfikësve ka automjete të reja, gjithashtu edhe gjatë kësaj periudhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës-APK ka bërë furnizime me uniformë të re për shuarjen e zjarrit, ndërsa pajisjet tjera dhe mjetet i siguron Komuna. APK gjithashtu ka angazhuar një kontingjent për intervenime gjatë këtij sezoni. Krahas kësaj me Policinë e Kosovës Shërbimi i Zjarrfikësve çdo vikend ka njësi patrulluese në liqenin e Batllavës.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, e hap diskutimin.

Nëse nuk keni diçka rreth informatave të paraqitura nga Drejtorët, e përmbysim edhe këtë pikë të rendit të ditës. Do të ishte mirë që në funksion të parandalimit të kemi një koordinim të KKSBB me dy KLSB-të që të kemi informim më të shpejtë, më efektiv në paraqitjen e parë të zjarrit, pra duhet të kemi një sistem të mirë të informimit, sepse intervenimi më i hershëm do të ishte shumë më efikas, andaj ju bëj ftesë edhe dy përfaqësuesve të KLSB-ve që janë prezentë këtu që bashkë me anëtarët e KKSBB-së dhe qytetarët që jetojnë në këto dy zona të cilat i përfaqësojnë të kenë në dispozicion edhe numrat e tel. privat të juaj në mënyrë që informata të qarkulloj sa më shpejtë në momentin e paraqitjes së zjarrit, sepse ne ende nuk kemi arritur ta bëjmë sistemin e informimit sikurse në vende tjera, me pajisje të alarmit për intervenim të shpejtë. Kalojmë në pikën e radhës.

4. Informatë dhe diskutim për projektet (të infrastrukturës dhe të shërbimeve) që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve, që mund t'i propozohen drejtorive për miratim në Kuvendin Komunal, gjatë periudhës së miratimit të buxhetit të komunës

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, në fjalën hyrëse përmenda disa planifikime ose prioritete të dala edhe nga Këshilli, që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve. Sikurse jeni të informuar jemi në proces të instalimit të kamerave të sigurisë në qytet por nuk do të thotë se vetëm kjo pjesë do të duhej mbuluar me kamera apo me ndriçim publik. Nuk kemi të dhëna të sakta por në lagjet ku ka ndriçim publik jam shumë i bindur ka edhe rënie të aktiviteteve kriminale. Drejtoritë përkatëse i kanë bërë draftet e para të planifikimit të buxhetit, por deri në muajin shtator kur edhe përfundon afati kohor për planifikim të buxhetit, nëse ka ndonjë projekt që do të mund të ndikonte drejtpërdrejtë në sigurinë e qytetarëve atëherë do të ishte mirë që edhe KKSBB të ketë propozime.

znj. Antigona Çitaku Dibrani, theksoi nevojën dhe rëndësinë e disa projekteve, me theks atë të ndriçimit në raport me shkallën e aktiviteteve kriminale dhe veprimeve tjera të kundërligjshme, si dhe për dhënien e prioriteteve të shtrirjes duke veçuar lokacionet me numër më të madh të banorëve. Nënvizoi, viteve të kaluar sikurse jeni në dijeni, në bazë të raportimeve, përdorimi i narkotikëve ka shënuar rritje dhe është përhapur në tërë territorin e Kosovës, e ndaj kësaj dukurie nuk ka mbetur imun as Komuna jonë. Numri i rasteve të identifikuar nga Policia të përdoruesve të narkotikëve ka një rritje në komunën tonë duke përfshirë mosha të ndryshme, por që më shqetësuese është mosha minorene. Ide që do të ndikonte në një masë në parandalimin e kësaj dukurie dhe në sigurinë e përgjithshme, e që në këtë rast kemi edhe ankesa të qytetarëve ku minorenë të shumtë sidomos në orët e mbrëmjes shfrytëzojnë hapësirat e objekteve të banimit publik dhe atë kryesisht në korridoret e tyre pasi që nuk kanë dyer dhe që mbyllen në hyrje të objekteve, e që mundësitë për hapje t'i kenë vetëm banorët, është që të shqyrtohen mundësitë e futjes në buxhet të Komunës sigurimi i dymve në hyrjeve të objekteve të banimit kolektiv. Kjo do të ndikonte në parandalimin e kësaj dukurie. 70% të rasteve janë që po i shfrytëzojnë këto objekte.

z. Osman Kurtolli, theksoi, është një shqetësim i imi për faktin se Komuna jonë i përket një regjioni, atë të Prishtinës që ka rreth 600,000 banorë. Mendimi im është që kjo reflekton edhe në çështjen e sigurisë publike. Fjala vjen mungesa e numrit të personelit policor rezulton nga kjo. Kjo reflekton edhe te Bashkësia Islame, apo kur kemi të bëjmë

me numrin jo të mjaftueshëm të rojeve të pyjeve, apo te të ardhurat të cilat burojnë te Komuna jona shkak është ky, sepse regjioni është shumë i madh që përfshinë 1/3 e territorit të Kosovës, e që numri i regjioneve në tërësi në Kosovë është shtatë(7). U theksua Komuna e Podujevës ka 633 km² dhe kjo ka domethënie për sigurinë publike. Gjithashtu u theksua numri prej 94000-95000 banorë, këtë numër ka edhe qyteti i Pejës që përfshinë një regjion. Komuna jonë prej 94,000 banorëve e që besoj se ka më shumë, rreth 135,000 banorë sepse e gjithë mërgata jonë janë banorë të Komunës sonë dhe të gjithë ata kanë nevojë për infrastrukturë rrugore, kanalizimeve, duhet të jetë qendër regjionale. Pra qëllimi është që ne të shkëputemi prej këtij regjioni apo të formojmë regjion në vetë. Pra këto që përmenda ndikojnë në çdo aspekt, shembull konkret, gjatë viteve të 90-ta kërkesa ime ishte që në aspektin organizativ shkolla në fshatin Shajkoc të ndahet nga fshati Sfeçël dhe të bëhet shkollë me Drejtorin në vetë dhe kjo u realizua. Në Bashkësinë Islame, regjionet kanë pasur nga një përfaqësues në Kryesi dhe Komuna e Podujevës nuk ka pasur për arsye se ka qenë në kuadër të regjionit që përmenda, dhe unë pata kërkuar që akti normativ i BI të ndryshojë dhe të përfshihet edhe Komuna e Podujevës dhe kjo është realizuar. Mendoj se është e nevojshme të punohet në këtë drejtim.

z. Nexhmi Rudari Nënkrjetar i Komunës, me Kushtetutën dhe Ligjet e Republikës së Kosovës pushteti është i ndarë në nivel qendror dhe atë lokal, pra nuk kemi pushtet regjional, megjithatë Policia e Kosovës është e organizuar edhe në nivel regjional, apo kur flasim për OSBE-në, por kjo nuk do të thotë që ne nuk kemi të drejtë të ligjshme sikurse Komuna e Gjakovës e cila para dy-tre viteve me insistimin e vazhdueshëm i është kthyer atributi i qendrës regjionale, tash Gjakova është qendër regjionale, e cila pas lufte ishte në kuadër të regjionit të Pejës. Nuk kemi ndonjë arsye pse të mos veprojmë ngjashëm. Kjo do të ndikonte në mirëqenien e qytetarëve të Komunës edhe në ofrimin më të mirë të shërbimeve nga niveli lokal, si dhe përmirësimin e gjendjes së sigurisë për qytetarët tonë, por kjo duhet të shkojë në institucionet përkatëse. Propozimi evidentohet dhe mbetet ta paraqesim në institucionet përkatëse.

z. Liman Zeqiri, theksoi, kam një shqetësim lidhur me çështjen e ambientit. Problem jo vetëm te ne por edhe në regjion janë ujërat e zeza. Ka 3 vite që është në proces ndërtimi i kolektorit në rajonin ku jetoj unë, aty ku ka mbetur i hapur kanalizimi dhe është një situatë shumë shqetësuese dhe alarmante sepse mund të ketë edhe infeksione. E di që projekti ka një kosto të lartë, por mundësisht të shqyrtohet dhe të parashihet për vitet e ardhshme, sepse e dimë që impiantet kanë një kosto jashtëzakonisht të lartë, por mundësisht që kjo të parashihet në të ardhmen, që ujërat e zeza të hiqen prej lumenjve sepse është shqetësim edhe i banorëve, por edhe mediat janë marrë me këtë çështje.

z. Nexhmi Rudari Nënkrjetar i Komunës, ne jemi në fazën e fillimit të ndërtimit të kolektorëve, projekt i cili do të realizohet me kredi nga Ministria e Financave të Austrisë dhe Banka Austriake. Të gjitha procedurat janë përmbyllur si në Kuvend ashtu edhe në Qeveri dhe shumë shpejtë pritet të fillojë ndërtimi i kolektorëve që do të grumbullojnë të gjitha ujërat e zeza që aktualisht derdhen në lumenjtë në territorin e Komunës së Podujevës. Ky projekt pritet të përfundojë në vitin e ardhshëm. Të gjitha ujërat e zeza do të eliminohen nga lumenjtë pastaj së bashku me Qeverinë pritet që të fillojë ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujërave të zeza jashtë kufirit administrativ të territorit të Komunës së Podujevës. Ajo që u theksua për ambient, ne para dy jave kemi pasur dy debate publike për dy draft rregullore; draft Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave dhe draft Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilat pritet të miratohen në Kuvend dhe janë shumë të rëndësishme sa i përket ambientit.

z. Qefser Behrami, theksoi, nëse ka mundësi që në planifikim të buxhetit të parashihet vazhdimi i shtrirjes së rrjetit të ndriçimit në rrugën në fshatin Kërpimëh.

5. Të ndryshme

Nuk pat diskutime

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, e përmbylli takimin duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën.11:30

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-060/04-0051420/19
Podujevë, 26 qershor 2019

Kryetari i Komunës
Agim Velu